

**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova**  
**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic**

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI<sup>45</sup>, mbledhja e 1) me dt.29.01.2021 (e premte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


**R E N D   D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Statutit të Ansamblit të këngëve dhe valleve në Obiliq
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës
5. Shqyrtimi i Propozimvendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë (Zona industriale - Llazarevë)
  - a) Nic Home SH.P.K
  - b) Tehno Burimi d.d
  - c) NTP "trod ex"
  - d) One Group SH.A
  - e) Aztech SH.P.K
  - f) B.P Home Invest
  - g) N.T.P "EBF"
  - h) N.M.A sh.p.k
  - i) Termo Pan
  - j) CNC.SHPK
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

*Burim Gërguri*  
**Burim Gërguri**



Dalës-Izlazna

Nr. -1-06  
Br.

Data 22.01.2021  
Datum:

OBILIQ-OBILIC



**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova**  
**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic**

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.12.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Sherif Hoti, Menaxher i Prokurimit, Hamit Mjeku, udhëheqës në DSHPE, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara:
  - a) Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e dt.30.11.2020 dhe
  - b) Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e dt.11.12.2020
3. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2021
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

**Aziz Bici** – Propozoj që rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të shtyhen për mbledhjen e ardhshme për arsye se ju e dini se na kanë ardhë me dt.28 rreth orës 15. Mendoj se këto pika që i ka rekomandue KPF-ja, dojnë një kohë më të gjatë që ne ti lexojmë, ti shfletojmë dhe të japim kontributin tonë. Në rast se këto nuk shtyhen për seancën e radhës, në shenjë të mosrespektimit të Rregullores së punës, që së paku 7 ditë duhet para afatit të na dorëzohet materiali, ne do ta lëshojmë seancën. Ju ftoj edhe juve që të japni kontributin tuaj dhe të shtyhen rekomandimet, përndryshe shfrytëzoj rastin të ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të dt.30.11.2020, të korrigjohet pjesa rreth vizitës të shkollës “17 Shkurti” sepse mund të ketë keqkuptime për formën se si është shkruajtur aty. Për të sqaruar këtë unë kam thënë se nuk qëndron fakti se unë aty kam shkruar si inspektor për shkak se nuk është as në natyrën time, as në qëllimin që ata ti zë në pozitë të palakmueshme. Unë kam thënë se në ditën e parë të vizitës në shkollën në Mazgit të Epërm nuk ka pasë dezinfektues, ndërsa në ditën tjetër po. Unë kam thënë se në gjimnazin “17 Shkurti” korridoret kanë qenë të mbyllura dhe qasja nuk është e mundur as me drejtorin të takohemi përveç rastësisht e kam takue punëtorin për mirëmbajtje në hyrje të shkollës, ka qenë vetëm një dezinfektues dhe ai nuk ka qenë funksional. Gjithashtu, nuk ka pasë as nxemje.

**Kryesuesi** – Rekomandimet nuk janë pikë e rendit të ditës dhe kur vijmë te rekomandimet mund ti shtyejmë një nga një. Kuvendi vendosë a me i votue, apo mos me i votue.

**Aziz Bici** – Ju, nuk e keni për herë të parë kështu, po e dërgoni materialin me lexue 2 ditë përpara, nuk e keni mirë. Ju po fshehni pas këtyre lexim Rregulloreve, që vetëm të kaloj.

**Kryesuesi** – Jo, nuk kemi çka të fshehim.

Tani, anëtarët e LVV-së, e lëshojnë mbledhjen dhe dalin nga salla e Kuvendit komunal.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e miratuan rendin e ditës të cekur më lartë.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

Munguan 2 anëtarët e LVV-së, të cilët e lëshuan mbledhjen.

#### **Pika 2 e rendit të ditës ditës**

Miratohet ekstrakti i proceverbalit nga mbledhja e rregulltë e dt.30.11.2020 me vërejtjet e cekura më lartë, ndërsa ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e dt.11.12.2020 miratohet unanimisht nga të pranishmit pa vërejtje.

#### **Pika e 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** - Ne në KPF, e kemi shqyrtue formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2021 dhe është rekomanduar që Komisioni të përbëhet prej 5 anëtarëve.

**Hysni Mjeku** – Propozon z.Lulzim Sadiku për anëtar të Komisionit..

**Linda Sadiku** – Propozon z. Fatos Kurshumlija.

**Dragan Dancetovic** – Propozon z.Slavisa Spasic.

**Kryesuesi** – Propozon z.Valmir Sadikun nga shoqëria civile. Po ashtu meqë z.Fatmir Bekteshi është nëpër Komisione, propozoj të ndërrohet me z.Nazmi Gashin, i cili e ka një përvojë të gjatë dhe besoj se me këtë dakordoheni edhe ju.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e miratuan Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2021 me këtë përbërje**

- 1.Lulzim Sadiku, Kryetar
- 2.Fatos Kurshumlija, anëtar
- 3.Nazmi Gashi, anëtar
- 4.Slavisa Spasic, anëtar
- 5.Valmir Sadiku, anëtar

#### **Pika e 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Ju njoftoj se ka ardhë një kërkesë jashtë afatit, që është nga Qendra për punë sociale dhe si kryesues propozoj që kjo kërkesë ti drejtohet për shqyrtim DSHMS-së.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal, unanimisht u pajtuan që kërkesa e cekur më lartë ti dërgohet DSHMS-së për shqyrtim.

**Kryesuesi** – Paraqet rekomandimin e KPF-së, për Propozim vendimin e Kryetarit për miratimin paraprak të listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite. Këtu, bëhet fjalë për parcelat në zonën industriale në Llazarevë, për 18 parcela që planifikohet në vitet e ardhshme të jepen në shfrytëzim. Është procedurë dhe obligim ligjor që çdo vit të merret vendim që këto të dalin në web faqen zyrtare në mënyrë që qytetarët të dinë se për çka kanë të drejtë të aplikojnë.

**Lulzim Sadiku** – Ju falenderoj, njëkohësisht për punën që e keni bërë për këtë vit bukur të rëndë me covid, me probleme të ndryshme me këtë sëmundje që vërtetë e ka përfshi ballkanin, që e ka lëndue Komunën tonë me shumë raste të vdekjes. Neve, materiali vërtetë na ka ardhë shumë vonë dhe për shkak se nuk kemi mund me analizue mirë propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Unë pajtohem edhe me parafolësin, anëtarin e LVV-së, meqë është pikë bukur e ndjeshme, që ta shtyejmë për seancën tjetër.

**Kryesuesi** – Sqaron se është procedurë vetëm me paraqitë në web faqen zyrtare, për shkak të transparencës që njerëzit ti shohin parcelat, asgjë më shumë.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për dhe 2 vota abstenim e miratuan Propozim vendimin nr.II-1713, të dt.24.12.2020, i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të**

**Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Listën e veçant të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite për vitin vijues.**

**Kryesuesi** – Paraqet rekomandimin e KPF-së, për miratimin e Procesverbalit përfundimtar nga Komisioni komunal lidhur me shqyrtimin e lëndës Cnr.847/08, të dt.16.11.2011.

**Nazmi Gashi** – Komisioni e ka kryer detyrën e vet në bazë të vendimit dhe ne si Komision e kemi përpiluar procesverbalin përfundimtar, që ta njoftojmë Kuvendin komunal. Mendoj se ka qenë telashe mjaft e madhe sepse edhe vendimet e Gjykatës, po na vijnë jo të qarta dhe pas 15 viteve me shqyrtue një lëndë, që as rrethanat e mundësitë nuk janë që Komisioni me bë ndarje qysh ka kërkuar me vendim Gjykata. Madje, Gjykata e favorizon personin znj.Fatime Krasniqi që ka qenë përfituese, por tash kujt me ia marrë banesën dhe me ia dhënë znj.Fatime Krasniqi. Prandaj, ne është dashur të marrim një rekomandim të kapshëm, një procesverbal të kapshëm, të logjikshëm për Kuvendin, i cili është mirë që të votohet.

**Linda Sadiku** – Ne para 2 seancave kemi formuar një Komision për të marrë vendim rreth kësaj lënde, ndërsa sot na vjen vetëm një rekomandim i tyre, që komplet është në kundërshtim me vendimet e Gjykatës dhe komplet ne si anëtarë të Kuvendit, po dalim në lajthitje.

I nderuar kryesues, kërkoj nga ju sinqerisht që çfarëdo votimi që të ndodhë këtu, mos të nënshkruani diçka që është në kundërshtim me vendimet e Gjykatës sepse në fund të fundit ne si anëtarë të Kuvendit nuk do të akuzohemi për votat tona, por ju si kryesues do të akuzoheni për nënshkrimin tuaj.

**Kryesuesi** – Unë obligohem sipas ligjit dhe Rregullores së punës së Kuvendit, që me i krye detyrat e punës së Kuvendit.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për 4 vota kundër dhe 2 vota abstenim e miratuan Procesverbalin përfundimtar me nr.II-1715, të dt.28.12.2020, i nxjerrur nga Komisioni i formuar nga Kuvendi komunal për shqyrtimin dhe zbatimin e Aktgjykimit nr.Cnr.847/08, të dt.16.11.2011.**

**Kryesuesi** – Paraqet rekomandimin e KPF-së, për shqyrtim dhe aprovim të kërkesës së DSHPE-së, për dhënie e donacionit kombit për bartjen mortore Bashkësisë islame në Obiliq.

**Enver Gashi** – Propozoj që kombit ti vendoset një llogo si shenjë e Komunës, që është donacion prej Komunës.

**Nazmi Gashi** – Ne e patëm një rast vdekje, por nuk i patëm njerëzit për me çelë varrin.

**Kryesuesi** – Ne në mbledhjen e fundit kemi marrë vendim për themelimin e Ndërmarrjes publike lokale “Kastrioti” dhe në vitin e ardhshëm kjo çështje do të rregullohet.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për e miratuan vendimin për dhënie e donacionit kombit për bartjen mortore Bashkësisë islame në Obiliq.**

**Pika e 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Me rastin e festës së vitit të ri 2021, ju uroj çdo të mirë juve dhe familjeve tuaja, shëndet

**Kryetari** – Ky vit ka qenë një vit i vështirë për të gjithë neve, sinqerisht kemi bërë përpjekje të gjithë ne në rrethanat e pandemisë që të ju ndihmojmë qytetarëve. Ju, keni qenë ata për me iu ndihmue qytetarëve, ndërsa ne i kemi implementue vendimet e Kuvendit komunal. Prandaj, ju uroj vitin e rid he të gjitha të këqijat e këtij viti qofshin të harruara. Po ashtu, ju shprehu ngushllime familjeve, që kanë humbë të afërmit e tyre me shpresën se në të ardhmen edhe vaksina do të ndodhë për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:50'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesi i Kuvendit komunal**

  
Burim Gërguri